



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS GLLOGOC

Numri i lëndës: 2019:182897

Datë: 15.04.2024

Numri i dokumentit: 05623460

C.nr.259/23

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË GLLOGOC-Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil, gjyqtarin Jeton Krasniqi me sekretaren juridike Ajshe Thaqi dhe bashkëpunëtorin profesional Dardan Elshani, në çështjen juridike të paditësve Z.K, V.K.1, D.K, A.K.1, V.K.2, I.K, K.K.1 dhe H.K.1 (të cilën e përfaqëson kujdestarja-përfaqësuesja e saj N.K), që të gjithë nga Komuna e Glllogocit të cilët i përfaqëson e autorizuar e tyre F.G nga Prishtina, kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës(KEK)- Prishtinë, lidhur me Kompensimin e Dëmit, vlera e kontestit 53.000 €, në seancën e shqyrtimit kryesor publik të mbajtur në këtë gjykatë me datën 04.04.2024, në prezencën e të autorizuarës së paditësve, e në mungesë të përfaqësuesit të të paditurës, me datë: 15.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET PJESËRISHT SI E BAZUAR KËRKESËPADIA e paditësve Z.K, V.K.1, D.K, A.K, V.K.2, I.K, K.K.1 dhe H.K, që të gjithë nga Komuna e Glllogocit dhe **DETYROHET** e paditura Korporata Energjetike e Kosoves(KEK) - Prishtinë që paditësve t’ua kompensoj dëmin e pësuar si pasojë e humbjes së familjarit të tyre H.K.2 në aksidentin e datës 27.11.2009, për përgjegjësinë e KEK-ut prej 30 %, si vijon:

Dëmin jo material:

- Në emër të dhimbjeve shpirtërore për H.K1, shumën prej 6,000.00 €;
- Në emër të dhimbjeve shpirtërore për Z.K, shumën prej2,500.00 €;
- Në emër të dhimbjeve shpirtërore për V.K.1, shumën prej1,500.00 €;
- Në emër të dhimbjeve shpirtërore për D.K, shumën prej1,500.00 €;
- Në emër të dhimbjeve shpirtërore për I.K, shumën prej1,500.00€;
- Në emër të dhimbjeve shpirtërore për V.K.2, shumën prej1,500.00 €;
- Në emër të dhimbjeve shpirtërore për A.K.1, shumën prej1,500.00 €
- Në emër të dhimbjeve shpirtërore për K.K.1, shumën prej1,500.00€, apo shumën e përgjithshme për dhimbjet shpirtërore prej **17,500.00 €**

Dëmin material

- në emër të shpenzimeve të varrimit për të ndjerin H.K.2, shumën prej **500.00 €**, apo shumën e përgjithshme prej **18,000.00 €**, të gjitha këto shuma të miratuara e paditura duhet t'ia paguaj paditësve me kamatë ligjore siç i paguajnë bankat për mjetet pa destinacion të caktuar duke filluar nga data e ushtrimit të padisë e deri në pagesën përfundimtare, si dhe ti kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej **4,704.76 €**, të gjitha këto detyrohet e paditura paditura Korporata Energjetike e Kosovës(KEK), që t'ua paguaj paditësve në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së aktgjykimit nën kanosjen e përmbarimit ligjor.

II. REFUZOHET E PA BAZUAR KËRKESËPADIA e paditësve e cila ka të bëjë për kompensimin e dëmit jo material në shumën më të lartë se sa shuma e aprovuar si në pikën I të dispozitivit të këtij Aktgjykimi dhe atë:

për dëmin jo material shumat si vijon:

- Në emër të dhimbjeve shpirtërore për H.K.1, shumën prej14,000.00 €;
- Në emër të dhimbjeve shpirtërore për Z.K, shumën prej5,500.00 €;
- Në emër të dhimbjeve shpirtërore për V.K.1, shumën prej2,500.00 €;
- Në emër të dhimbjeve shpirtërore për D.K, shumën prej2,500.00 €;
- Në emër të dhimbjeve shpirtërore për I.K, shumën prej2,500.00 €;
- Në emër të dhimbjeve shpirtërore për V.K.2, shumën prej2,500.00 €;
- Në emër të dhimbjeve shpirtërore për A.K.1, shumën prej2,500.00 €;
- Në emër të dhimbjeve shpirtërore për K.K.1, shumën prej2,500.00 €

Dhe

për dëmin material

dhe atë:

- Në emër të rregullimit të lapidarit shumën prej500.00 €
- Për shpenzimet e procedurës më të lartë se sa shuma e gjykuar si në pikën I të dispozitivit, përkatësisht shuma prej 264.00 €.

A r s y e t i m

Paditësit në padi dhe kërkesëpadinë e precizuar përmes të autorizuarit të tyre, në shqyrtimin e mbajtur në këtë gjykatë kanë kërkuar që kërkesëpadia e tyre të miratohet në tërësi si e bazuar për format dhe shumën e precizuar, ashtu që të detyrohet e paditura Korporata Energjetike e Kosovës(KEK) – Prishtinë, që për shkak të vdekjes së H.K.2 nga goditja-kontakti i rrymës me datë 27.11.2008 në Glllogoc, paditësve t'ia kompensojë dëmin që e kanë pësuar si pasojë e vdekjes së babait të H.K.1 përkatësisht djalit të Z.K dhe vëllait të paditësve V.K.1, D.K, I.K, V.K.2, A.K.1 dhe K.K.1 dhe atë në emër të dëmit jo material: për dhimbjet shpirtërore për Z.K shumën prej 8,000 €, për H.K shumën prej 20.000€ dhe për paditësit(V.K.1, D.K, I.K, V.K.2, A.K dhe K.K.1)për secilin nga 4.000€, ndërsa për dëmin material që ka të bëjë me shpenzimet e varrimit për të ndjerin H.K.2, shumën prej 500.00 € dhe për ngritjen e përmendores shumën prej 500 €. Apo shumën e përgjithshme prej 53.000€, si dhe ti kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 4,968.76 €, të gjitha këto me kamatë siç i paguajnë bankat për mjetet pa destinacion të caktuar duke filluar nga data e ushtrimit të padisë e deri në pagesën përfundimtare. Ndër të tjera në padi kanë theksuar se me datë 27.11.2009 në ora 18:00, pasi që H.K.2 ishte duke punuar si punëtor fizik në shtëpinë e N.H në Drenas, pas orarit të punës kishte

shpërthyer një gyp i ujit dhe i ndjeri H.K.2 duke dashur t'i dalë në ndihmë gjatë mbylljes së gypit i njëjti kishte pasur kontakt me kablion furnizuese të rrymës nga shtylla deri në restorantin "E...", duke shtuar se kabloja elektrike ishte shkaktare e vdekjes së H.K.2, e njëjta ishte e vendosur në mënyre ilegale dhe për këtë arsye e paditura ka përgjegjësi për kompensimin e dëmit të anëtarëve të familjes.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Glllogoc me aktgjykimin C.nr.372/19 të datës 31.03.2021, e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësve duke e detyruar të paditurën që paditësve në emër të dëmit material dhe jomaterial t'u paguaj shumën e përgjithshme prej 77.000€. Duke vepruar sipas ankesës së palës së paditur, Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin Ac.nr.4018/2021 të datës 10.07.2023, e ka aprovuar si të bazuar ankesën e të paditurës, duke e prishur aktgjykimin e kësaj gjykate dhe lëndën e ka kthyer në rigjykim dhe vendosje.

Në shqyrtimin kryesor të rigjykimit, përfaqësuesja e paditësve ka deklaruar se mbetet pranë padisë dhe kërkesëpadisë së precizuar si dhe pranë deklarimeve në seancat e kaluara. Tutje theksuar se super ekspertiza e përpiluar prej tre ekspertëve gjyqësor me të cilën kanë ardhur në përfundim lidhur me shkaqet e aksidentit me pasoja vdekjeprurëse (përkundër faktit që kjo super ekspertizë e ka ndarë përgjegjësinë konform mendimit profesional të ekspertëve) në raport me të paditurën KEK të aprovohet si e bazuar.

Në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim me datë 12.04.2024, e autorizuar e paditësve ndër të tjera ka theksuar se mbetet pranë padisë dhe kërkesëpadisë me disa ndryshime të cilat i ka deklaruar gjatë shqyrtimeve gjyqësore duke propozuar që pas analizimit të provave të aprovohet si e bazuar kërkesa për dëmshpërblimin nga e paditura. Tutje ka shtuar se duke u bazuar në super ekspertizën nga grupi i ekspertëve gjyqësor, në Ligjin e Marrëdhënieve të Detyrimeve dhe praktikën gjyqësore ka bërë precizimin e kërkesëpadisë dhe duke u bazuar në të, ka propozuar që e njëjta të aprovohet si e bazuar konform pjesës së përgjegjësisë që bie mbi KEK-un, e që shuma e përgjithshme për demin moral dhe material është 53.000€.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura përmes të autorizuarit të saj ka dhënë përgjigje në padi duke theksuar se e konteston në tërësi padinë dhe kërkesën e saj si për nga baza ashtu edhe për nga lartësia. Tutje ka theksuar se e paditura e nuk e ka legjitimitetit pasiv nga fakti se e paditura nuk është fajtorë për fatkeqësinë e ndodhur me datë 27.11.2008, çoftë ajo subjektive apo objektive dhe se përgjegjësia dhe fajësia bie në përgjegjësitë e familjes H... Tutje ka theksuar se me ndërhyrje të pa autorizuar të personave të tretë e në rastin konkret të familjes H... me veprime kundërligjore kanë ndikuar që rasti tragjik të ndodhë dhe të pasojë i ndjeri H.K.2. Ka shtuar se aksidenti nuk është shkaktuar nga rrjeti i të paditurës, ngase e paditura përgjigjet ekskluzivisht vetëm për rrjetin. Ndërsa sa i përket rastit konkret ka theksuar se nuk ka dyshim se kablo furnizuese është pronë e konsumatorit gjegjësisht familjes H..., pasi që atë kablo e ka vendosur kjo familje dhe pa pëlqim është kyçur në rrjet të të paditurës dhe atë kablo furnizuese e kanë zhvendosur dhe e kanë varur në rrethojë metalike gjithashtu pa pëlqimin e të paditurës.

Në shqyrtim kryesor të rigjykimit te datës 20.11.2023, i autorizuari i te paditurës ka deklaruar se mbetet në tërësi si në përgjigje në padi, deklaramet si në seancat e mbajtura me pretendimet ankimore lidhur me këtë çështje juridike. Tutje ka propozuar që të vazhdohet sipas sugjerimeve të Gjykatës së apelit, fillimisht lidhur me kompensimin e paditës H.K.1, pastaj me dëshmitarët

relevant lidhur me këtë çështje si dhe hartimin e ekspertizës nga grupi i eksperteve të lëmesë së mbrojtjes dhe sigurisë në punë.

E paditura nuk ka marrë pjesë në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 04.04.2024, edhe pse ftesën e kishte pranuar me datë 08.03.2024, por nuk e ka arsyetuar mungesën. Pastaj gjykata me propozimin e të autorizuarës së paditësve ka marrë aktvendim dhe seancën e shqyrtimit kryesor e ka mbajtur në mungesë të paditurës duke u bazuar në nenin 423.4 të LPK-së.

Gjykata në këtë çështje juridike - kontestimore me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, sipas propozimit të palëve të pranishme ka zhvilluar procedurën në të cilën janë administruar këto prova si: Vërtetimi mjekësor për vdekjen të datës 15.12.2008, Certifikata e lindjes me nr... dhe nr. të referencës... e datës 06.08.2009; Certifikata e vdekjes me nr. rendor... dhe nr. të referencës... e datës 22.05.2009; deklarata e bashkësisë familjare e datës 19.10.2009; Certifikata e lindjes me nr. rendor... dhe nr. të referencës... e datës 13.03.2009; certifikata e lindjes me nr. rendor... dhe nr. të referencës... e datës 29.04.2009; raporti i veçantë i rastit të Prokurorisë Publike të Qarkut në Prishtinë me nr. të rastit... i datës 10.03.2009; raporti fillestar i incidentit i datës 28.11.2008; procesverbali mbi intervistimin e të dyshuarit i datës 28.11.2008; deklarata e të dyshuarit N.H e datës 28.11.2008, procesverbali mbi intervistimin e të dyshuarit A.H i datës 28.11.2008, deklarata e të dyshuarit A.H e datës 14.01.2009 e dhënë në Stacionin Policor në Drenas; deklarata e ankuesit Sh.Sh e datës 29.12.2008; procesverbali mbi intervistimin e dëshmitarit F.P i datës 27.11.2008, deklarata e të dyshuarit e datës 24.02.2009; deklarata e të dëmtuarit V.K.1 e datës 27.11.2008; deklaratat e F.P dhe R.E të datës 28.11.2008; raport i shpejt me shenjen... i datës 27.11.2008; raport i oficerit dt. 27.11.2008 i stacionin policor në Drenas; raport i oficerit hetues i datës 27.11.2008 në Drenas; raporti mjekësor i datës 27.11.2008; raporti mjekësor në QKUK në Prishtinë i datës 28.11.2008; fotografitë e vendit të aksidentit në tetë(8) faqe; raport i shtëpisë së Shëndetit në Drenas me nr... i datës 27.11.2008; vendimi mbi kërkesën për beneficion të invalidëve të luftës dhe të afërmit të tyre me nr... i datës 15.08.2002; deshmia e dëshmitarit F.P dhe R.E të dhëna në seancën e datës 08.06.2012; raporti i veçantë i rastit me shenjen PPN.nr... i datës 13.11.2009, dëshmitë e dëshmitarëve A.H dhe N.H të datës 08.06.2012, transaksion i konsumatorit nga data 09.03.2007 deri me datë 05.09.2012, ekspertiza teknike për vërtetimin e shkakut të paraqitjes së zjarrit e përpiluar në muajin Mars 2012 sipas shenjës C.nr... nga Eksperti Y.Z; sqarim i Ekspertit Y.Z në seancën e datës 15.04.2014; mendimi i ekspertëve të neuropsikiatrisë Dr. V.S të dhënë në seancën e datës 22.04.2014; ekstrakt i lindjes i datës 23.04.2014 për K.K.2; kontrata për ndërtim e lidhur në mes të V.K.3 dhe gurdhënësit 'F...', në Klinë e cila nuk ka datë; certifikata e vdekjes me nr... e datës 31.01.2020, aktvendimi mbi caktimin e kujdestarisë Herolinda Krasniqi lëshuar nga QPS në Glllogoc, me nr... i datës 31.01.2020; ekspertiza e lëmisë së mbrojtjes dhe sigurisë në punë e ekspertit H.N e datës 28.02.2020; sqarim i ekspertit H.N në procesverbalin e datës 24.12.2020; plotësimi i ekspertizës së ekspertit H.N i datës 30.12.2020; ekspertiza e ekspertit financiar A.B e datës 11.01.2021; sqarimi i ekspertëve H.N dhe A.B në seancën e datës 10.02.2021; superekspertiza e grupit të ekspertëve A.K.2, R.Z, R.B e datës 21.03.2024; sqarim i ekspertëve të mbrojtjes dhe sigurisë në punë A.K.2, R.Z dhe R.B në seancën e datës 04.04.2024 dhe deshmia e palës V.K.2 e dhënë në seancën e datës 04.04.2024.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku e në lidhmëri njëra me tjetrën, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 8, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata erdhi në përfundim se në këtë çështje juridike – kontestimore duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Nga provat e administruara, gjykata ka konstatuar se i ndjeri H.K.2 ka qenë duke punuar si punëtor i ndërtimtarisë të N.H, duke kryer punë të brendshme (lyerja me gletë) së bashku me punëtor tjerë. Pasi kishin përfunduar punën, mbrapa objektit ku punonin ishte paraqitur një rrjedhje e ujit nga një lokal në afërsi dhe për ta evituar prishjen e atij gypi kishte dalur N.H dhe H.K.2 tani i ndjerë. Gjatë përpjekës së mbylljes së gypit nga N.H, H... kishte shkuar për ti ndihmuar dhe dyshohet se kishte hasur në një rretë metali e cila kishte pasur kontakt me kabllon furnizuese nga shtylla elektrike deri në restorantin ‘E...’. Në momentin kritik rryma elektrike kishte goditur dy personat e cekur me lart ku aty kishte pësuar H.K.2 ndërsa N.K kishte marrë ndihmë mjekësorë.

Në bazë të Certifikatës së vdekjes të datës 22.05.2009 me nr. rendor... dhe nr. të referencës... të lëshuar nga zyra e gjendjes civile në Glllogoc, konstatohet së H.K.2 ka vdekur me 27.11.2008.

Gjendja faktike për vdekjen e të ndjerit H.K.2, vërtetohet edhe nga vërtetimi mjekësor i datës 15.12.2008, raporti i veçantë i stacionit policor në Glllogoc me nr... i datës 24.03.2009, raporti fillestar i incidentit i stacionit policor në Drenas i datës 28.11.2008, nga procesverbali – deklarata e N.H e datës 28.11.2008 të dhënë Policisë në Drenas, deklarata e dëshmitarit Sh.Sh të datës 14.01.2009 në stacionin policor në Drenas, deklarata e dëshmitarëve N... dhe A.H të datës 08.06.2012.

Në bazë të deklaratës së bashkësisë familjare nr... të datës 19.10.2009 të lëshuar nga zyra e gjendjes civile në Glllogoc, konstatohet se paditësit në kohën e vdekjes së të ndjerit H.K.2, kanë jetuar në të njëjtën bashkësi familjare me të.

Në bazë të mendimit të ekspertes së Neuropsikiatrisë Dr. V.S të dhënë në seancën e datës 22.04.2014, konstatohet se sa i përket paditëses Z.K me rastin e humbjes së djalit të saj H... ka ekzistuar dhimbja shpirtërore e cila është manifestuar me pikëllim të shkallës së lartë, me pagjumësi, disponim depresiv dhe shqetësime. Kjo dhimbje shpirtërore ka qenë e intensitetit të lartë dhe ka zgjatë 6 muaj, ndërsa dhimbja shpirtërore e intensitetit mesatar ka zgjatë një vit, dhimbja e intensitetit të ultë është shprehur gjatë përvjetorëve, festave dhe është prezente edhe sot e kësaj dite edhe disa vite me radhë. Për paditësin V.K ka konstatuar se i njëjti ka përjetuar pikëllim të thellë menjëherë pas humbjes së vëllait që është përcjellë me shqetësim, mërzitje, inkotinencë emocionale, ky pikëllim ka qenë i natyrës depresive i shkallës së rëndë duke marr parasysh humbjen e vëllait. Dhimbja shpirtërore e intensitetit të lartë ka qenë e shprehur 5 muaj, dhimbja shpirtërore e mesme ka qenë e shprehur një vit, ndërsa dhimbja shpirtërore e ultë është prezente dhe do të jetë prezente sa herë që do të këtë festa ose gjatë përvjetorëve. Për paditësin D.K ka konstatuar se i njëjti ka përjetuar pikëllim të thellë pas marrjes së lajmit për humbjen e vëllait, ankth, inkotinencë emocionale, ky pikëllim ka qenë reaksion i natyrës depresive dhe ka qenë i rëndë ngase ka qenë larg familjes dhe nuk ka mundur ta ndaj dhimbjen me askënd. I njëjti ka përjetuar dhimbje shpirtërore të shkallës së lartë e cila ka zgjatur 6 muaj, dhimbja e shkallës së mesme ka zgjatur 1 vit dhe dhimbja shpirtërore e shkallës së ultë është prezente edhe sot dhe do të jetë prezente gjatë përvjetorëve ose festave të ndryshme familjare. Për paditësen I... dhe V.K.1-motrat e të ndjerit H.K.2, ka konstatuar se të njëjtat kanë përjetuar pikëllim të thellë menjëherë pas humbjes së vëllait dhe është manifestuar me konfuzion, shqetësim, çrregullim të ritmit të gjumit, zgjime të shpeshta gjatë natës. Ky pikëllim dhe reaksion ka qenë i natyrës depresive i shkallës së rëndë, duke marr parasysh lidhjen e motrave me vëllain. Dhimbja shpirtërore e përjetuar ka qenë e shkallës së lartë dhe ka zgjatë 5 muaj, dhimbja shpirtërore e shkallës së mesme ka zgjatë një vit dhe dhimbja shpirtërore e shkallës së ultë është prezente edhe sot dhe do të jete prezentë ne çdo mbledhje apo përvjetor familjar. Për paditësin K.K.1 ka konstatuar se i njëjti ka përjetuar pikëllim të thellë menjëherë pas humbjes së vëllait dhe është

përcjellë me ankth, çrregullim të ritmit të gjumit, zgjime të shpeshta të përcjellura me tmerre të natës si dhe konfuzion. Ky pikëllim ka qenë i natyrës depresive dhe ka qenë i shkallës së rendë. Dhimbjet shpirtërore kanë qenë të intensitetit të lartë dhe kanë zgjatë 5 muaj, dhimbja shpirtërore e shkallës së mesme ka zgjatë 1 vit, ndërsa dhimbja shpirtërore e shkallës së ultë është prezentë dhe do të jetë prezente edhe disa vite me radhë, sidomos gjatë festave, takimeve të ndryshme familjare si dhe në përvjetorë të të ndjerit. Ndërsa sa i përket H.K.1 (Vajza e të ndjerit H.K), ka konstatuar se e njëjta nuk ka mundur të përjetoj dhimbje shpirtërore, ngase ajo ka qenë fetus në barkun e nënës.

Në bazë të ekspertizës së ekspertit H.N të datës 28.02.2008, dhe plotësimit të saj me datë 27.12.2020, është konstatuar se kablo elektrike në të cilën ka humbur jetën H.K.2 rezulton se ka qenë jashtë çdo norme dhe rregulle teknike, ashtu që nuk kanë plotësuar kushtet për kyçje dhe se përgjegjësia e të paditurës nuk ka qenë e ndarë nga shtylla e fundit por ka qenë deri në pjesën e pasme të njehsorit. Ndërsa në plotësimin e saj ka ardhur në përfundim se punëtorët e KEK-ut, kishin lejuar që N.H i cili kishte bërë kyçje ilegale duke e furnizuar lokalitë "E...", me nr të konsumatorit DPR... të trajtohet si konsumator i kyçur ilegal pasi nuk kishte pasur pëlqim elektroenergjetik për kyçje në rrejtin elektrik. Se është trajtuar si konsumator ilegal e tregon edhe shkurtësia para emrit dhe mbiemrit IL A.H. Punëtorët e KEK-ut kanë qenë të pakujdesshëm, nuk kanë kontrolluar gjendjen e kabllot, ngase nga raporti i policisë përshkruhet se ajo kabull ka pasur dëmtime mekanike dhe në foto të dokumentacionit vërehet qartë se kanë qenë të vendosura jashtë çdo norme dhe rregulle teknike. Sa i përket përgjegjësisë së N.H, ka theksuar se i njëjti ka bërë shfrytëzim të pa autorizuar të energjisë elektrike dhe duke marr parasysh se kablo e dëmtuar ka qenë pronë e tij, ngase e ka blerë vet dhe vendosur vet në pronën e tij, nuk ka pasur vëmendjen para se të ndodhë rasti tragjik, për ta larguar jashtë zonës së rrezikut nga fëmijët e familjes dhe personave tjerë të mundshëm. N.H si punëdhënës është dashur ta njoftoj të ndjerin për ato rreziqe, ta ndërpres punën së pari, për ta larguar në mënyrë të sigurt kabllon e dëmtuar. Andaj mbi bazën e këtyre, ka propozuar që KEK-u të mbanë përgjegjësinë primare rreth 65-70 %, ndërsa N.H të mbanë përgjegjësinë sekondare rreth 30-35%. Ndërsa sa i përket përgjegjësisë së të ndjerit H.K.2, ka konstatuar se i njëjti nuk mund të ketë asnjë përgjegjësi. Në seancën gjyqësore të datës 10.02.2021 ka deklaruar se plotësimin e ekspertizës respektivisht ndarjen e përgjegjësisë e ka bërë në bazë të lëshimeve të të dy palëve. Andaj në bazë të këtyre lëshimeve ka rezultuar se KEK-u mbanë përgjegjësinë primare rreth 65-70% ndërsa N.H, mbanë përgjegjësinë sekondare rreth 30-35%. Përgjegjësia primare e KEK-ut rezulton ngase punëtorët e saj e kishin lejuar N.H i cili kishte bërë kyçje ilegale duke furnizuar lokalitë "E...", të trajtohet si konsumator i kyçur ilegal. Tutje ka theksuar se KEK-u është dashur që të mos lejoj që punëdhënësi të lidhet ilegalisht në rrjetin elektroenergjetik për arsye se ai në ndërtimin e objektit ka punuar një kohë të gjatë dhe nuk është mbikëqyrur nga ana e KEK-ut, e cila ka pasur obligim të përcjellë jo vetëm në këtë rast por në përgjithësi keqpërdorimin e klientëve të saj, sepse sikur i njëjti ta kishte përcjellore me kohë atë gjendje nuk do të kishte ardhur deri te pasojat të cilat kanë ndodhur.

Eksperti i elektroteknikës në ekspertizën teknike të datës 24.03.2014 ka konstatuar parregullsitë në mosrespektimin e procedurave nga ana e operatorit të rrjetit për ndërprerje dhe çkyçje të lidhjes së paautorizuar në rrjetin e operatorit e cila lidhje nuk ka plotësuar kushtet dhe kriteret teknike si dhe mangësitë dhe lëshimet në këtë rrjetë janë shkaktar të aksidentit me vdekje të H.K.2 me datë 27.11.2009 në ora: 18:00 në Drenas. Ndërsa në seancën e datës 15.04.2014 ka sqaruar se KEK-u duhet ti përmbahet të gjitha procedurave të cilat janë të aprovuara nga ZRRE-ja, ndërsa në rastin konkret hasja e një shfrytëzuesi të paautorizuar të energjisë elektrike si hap i parë ai duhet të c'kyqet nga rrjeti elektrik, t'i jepet një afat kohor që ai të kaloj në një shfrytëzues të rregullt të energjisë elektrike. Dështimi i parë është se në momentin kur është hasur duke e

shfrytëzuar në mënyrë të paautorizuar energjinë elektrike, nuk është shkyçur. Tutje ka theksuar se KEK-u mban përgjegjësinë që këto asete apo kabllot furnizuese të mbikëqyrën, kontrollohen dhe të jenë të rregullta para se të lëshohet leja për kyçje. Pas ç'kyçjes nëse konsumatori prap ri kyçet në mënyrë ilegale KEK-u është i detyruar që të marr kabllot dhe pajisjet, ku kjo është e përshtatshme edhe në bazë të rregulloreve të KEK-ut, dhe në bazë të dokumentacionit nuk kemi asnjë fakt se pala është paditur në Gjykatë për kyçje ilegale. Ka theksuar se kabllot furnizuese janë aset i konsumatorit "E...", dhe se shkaktar i vdekjes është rryma elektrike si pasojë e mosrespektimit të procedurave nga ana e KEK-ut, pastaj si pasojë e mangësive dhe lëshimeve teknike të kësaj kabloje.

Dëshmitari V.K.2 në cilësi të dëshmitarit në seancën kryesore ka deklaruar se me datë 27.11.2009 ka qenë prezent kur ka ndodhur rasti i vdekjes së H.K.2 të cilin e ka pasur vëlla. Ndër të tjera ka theksuar se N... i ka thënë H... që ti pastroj mjetet e punës, aty kishte qenë një cevë mbi pllakën e katit të parë, ku H... kishte dalur mbrapa dhe i ka thënë N... se kjo pjesë qenka me ujë dhe kur kishte shkuar në atë vend e kishte parë vëllain e tij të vdekur. Tutje ka shtuar se H... ka qenë punëtor i N... por nuk ka pasur kontrate pune dhe se nuk e ka parë duke lidhur tela të rrymës. Tutje ka theksuar se ngjarjen e ka parë në anën tjetër të rrugës ku ishte duke shitur qymyr dhe aty kam shkuar disa herë sepse vetëm rruga na ka ndarë.

Në bazë të super ekspertizës të datës 01.03.2024 së grupit të ekspertëve A.K, R.Z dhe R.B konstatohet se: a) Lëshimet e Korporatës Energjetike të Kosovës Sh. A janë ngase ka lejuar furnizimin me energji elektrike të konsumatorit-Restaurantit "E..." me pronar A.H me numër të njehsorit elektrik DPR... në mënyrë të palejuar, respektivisht ka toleruar lidhjen në shtyllën elektrike në mënyrë të pa autorizuar, për një kohë mbi një vit, gjë që dëshmon pasqyra e transaksioneve, nuk ka kontrolluar shtyllën për të cilën ka pasur njohuri se ka se paku një konsumator të kyçur ilegalisht, ka ri kyçur ose lejuar të ri kyçet konsumatori ilegal, pa dërguar ekipen profesionale në teren, të cilët do duhej të merrnin dëshmi nga vendi i rikyçjes, posaçërisht rreth kushteve teknike të kabllot prej shtyllës deri te objekti i restorant "E...". Ka lejuar vazhdimin e gjendjes së ri kyçur ilegalisht të konsumatorit edhe pas ndodhjes së rastit tragjik, gjendja teknike e kabllot në bazë të fotografive të punuara nga vendi i ngjarjes nga Policia e Kosovës, tregojnë gjendje të parregullt teknike të vendosjes së këtyre kabllot, me burime të rreziqeve të shumta nga goditja prej energjisë elektrike. b) Lëshimet e pronarit të restorantit "E...", janë ngase nuk ka paraqitur kërkesë me shkrim KEK-ut/OSSH për ta kyçur objektin komercial në rrjetin elektrik në mënyrë të rregullt teknike dhe të autorizuar nga personat kompetent, ka kyçur objektin e tij në rrjetin e shpërndarjes elektrike pa pasur paraprakisht pëlqimin nga KEK-u, pas shkyçjes që i është bërë me datë 31.07.2008, për shkaqe komerciale (grumbullim të borxhit), ka ri kyçur objektin arbitrarisht duke shkelur rregullat teknike, respektivisht ka lëshuar kabllon furnizuese të objektit nga pika e kyçjes në rrjet përgjatë shtyllës deri në tokë duke kaluar deri te objekti kabllot në mënyrë të pa lejuar dhe të pa sigurt, vendosja e kabllot në lartësi jo adekuate (nëpër rrjetë metalike) dhe nëpër tokë ka krijuar kushte për kyçje dhe shfrytëzim të energjisë elektrike nga të tjerët në mënyrë jo legale dhe të rrezikshme. c) Lëshimet e Punëdhënësit N.H janë ngase ka angazhuar në punë punëtorin e ndjerë H.K.2 si punëtor të ndërtimit në objektin e shtëpisë së tij në ndërtim pa kontratë ose ndonjë marrëveshje me shkrim për punët që do t'i kryej, nuk ka ofruar kushte të sigurta për punë, ka bërë shfrytëzimin e paautorizuar të energjisë elektrike duke lidhur kabllon furnizuese për nevoja të veta në kabllon e furnizimit të restorantit "E...". Kabllot e përdorura janë vendosur nëpër rrjetë metalike, të cilat sipas shkresave të lëndës kanë qenë me izolim të dëmtuar. Punëdhënësi i punëtorit të ndjerë ka bërë veprim të jashtëligjshëm dhe të rrezikshëm në aspektin e sigurisë dhe mbrojtjes në punë duke lidhur dy kabllot në mënyrë teknike të palejshme. Ka urdhëruar apo se paku ka lejuar punëtorin H.K.2 që të bëjë veprime jashtë detyrave të punës, pa kompetencë

profesionale dhe në ambient me dukshmëri të pa mjaftueshme me mjete punuese të rrezikshme. d) Lëshimet e punëtorit H.K.2i janë ngase ka pranuar të kryej veprime punuese për të cilat nuk ka qenë kompetent, respektivisht nuk ka pasur përgatitje shkollore dhe njohuri profesionale. Andaj mbi bazën e këtyre kanë ardhur në përfundim se shkaqet e lëndimit vdekjeprurës të punëtorit H.K.2 me datën 27.11.2008, me impakt dominant maksimal për ndodhjen e rastit janë lëshimet e bëra nga KEK-u, Restorant “E...”, dhe punëdhënësi N.H, kurse lëshimi i punëtorit është me impakt të karakterit sekondar.

Në seancën e shqyrtimit kryesor kryetari i grupit të eksperteve ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë ekspertizës, ndërsa në pyetjet e gjyqarit dhe të palëve ndërgjyqëse ka sqaruar se nga figura 5 shihet se nga shtylla lëshohen katër (4) kablllo përgjatë shtyllës në drejtim të tokës, po ashtu në figurën 6 ku shihet një pjesë e poshtme e shtyllës dhe rrjeta metalike për skaj saj shihet se janë 4 kablllo. Në figurën 7 janë të paraqitura vetëm 3 kablllo ku shihen ndrydhjet e izolimit të tyre nga kontakti me pjesë të forta metalike. Në figurën 8 shihen 4 kablllo të lëshuara për toke mbi të cilat shihet se vendosur tërthorazi një pjesë e armaturës, po ashtu në këtë figurë në pjesën e sipërme të sajë shihet kabllloja bistek në të cilën brenda shënimit me elipsa shihet se është e lidhur një kablllo tjetër me e hollë dhe me ngjyrë tjetër. Tutje ka sqaruar se çështja e caktimit të përgjegjësisë është në diskrecionin e gjykatës dhe ajo lehtë mund të caktohet meqenëse ajo varet nga numri i lëshimeve të secilit të involvuar në rast dhe influencë e secilit lëshim në ndodhjen e rastit. Në pyetjen se a është dashur KEK-u ti kontrolloj herë pas here në kuadër të punës rutinore se kush kyçet ilegalisht, i njëjti është përgjigjur se po e ka për obligim që sapo të marrë informatën e dërgon një komisoion në vendin e ngjarjes i cili e punon një procesverbal, ia bashkëngjijtë fotografitë dhe ja dërgon organeve të KEK-ut, duke shtuar se KEK-u ka pasur për detyrë që ti largoj këto kablllo por nuk ka vepruar dhe deri në vitin 2012 figuron si kyçje ilegale me inicialet I.L.

Super ekspertizën e ekspertëve të mbrojtjes dhe sigurisë në punë, gjykata e mori në tërësi si të bazuar dhe i dha besimin e plotë ngase ekspertiza përmban elementet e nevojshme të dhëna në bazë të njohurive profesionale.

Baza juridike e kërkesë padisë, që e padituri të jetë përgjegjëse për të kompensuar paditësin gjejnë mbështetje në dispozitat e nenit 154.1, 158, 200 dhe 206 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (Ligji mbi marrëdhëniet e detyrimeve, i datës 30 mars 1978).

Sipas dispozitës së nenit 154 par.1 të LMD-së, parashihet se “Kush i shkakton tjetrit dëmin ka për detyrë ta kompensojë, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij”, ndërsa me dispozitën e nenit 158 të Ligjit të njëjtë, parashihet se “Fajsia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia”.

Për lartësinë e kërkesëpadisë dhe për kategoritë e caktuara për aspektin e dëmit jo material gjykata vendosi duke u mbështetur në dispozitat e nenit 200 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve e lidhur me nenin 323 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, me këtë rast gjykata pati parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimit të cilit i shërben kompensimi i gjykuar, gjithmonë duke pasur parasysh që kompensimi të jetë satisfaksion për të dëmtuarit duke ndikuar kështu në zbutjen e pasojave negative që janë paraqitur si pasojë e dëmit në cenimin e vlerave personale të paditësve.

Për përgjegjësinë e ndarë në mes të palëve lidhur me aksidentin e ndodhur, gjykata është bazuar në ekspertizën e grupit të ekspertëve të lëmisë së Sigurisë dhe Mbrojtjes në Punë Dr. A.K, R.Z dhe R.B të cilët në mendimin e tyre kanë konstatuar se deri te aksidenti ka ardhur me lëshimet

Korpoatës Energjetike të Kosovës Sh.A, lëshimet e pronarit të restaurantit “E...” dhe lëshimet e punëdhënësit N.H, si lëshime me impakt dominant maksimal primar në ndodhjen e rastit dhe me lëshimet e të ndjerit H.K.2 me impakt të karakterit minimal sekondar.

Gjykata pasi konstatoi rrethanat e rastit duke pasur parasysh dhimbjet e përjetuara shpirtërore, intensitetin, dhe kohëzgjatjen e tyre, e duke marr për bazë edhe rrethanat tjera që ndikojnë në përcaktimin e lartësisë së kompensimit, praktikën e mirë gjyqësore, vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit në pjesën e aprovuar e duke marrë parasysh edhe kontributin e Korpoatës Energjetike të Kosovës Sh.A, restaurantit “E...” dhe lëshimet e punëdhënësit N.H, si lëshime me impakt dominant maksimal primar në ndodhjen e rastit dhe me lëshimet e të ndjerit H.K.2 me impakt të karakterit minimal sekondar.

Gjykata duke u bazuar në gjendjen e vërtetuar faktike si më lartë, sidomos në super ekspertizën e grupit të ekspertëve të lëmisë së mbrojtjes dhe sigurisë në punë, vlerësoi se e paditura KEK ka përgjegjësi prej 30 % për rastin e aksidentit me pasojë vdekje, resturanti “E...” ka përgjegjësinë prej 30 % dhe punëdhënësi N.K. ka përgjegjësinë prej 30 % ndërsa përgjegjësia ndaj të ndjerit H.K.2 është 10 %, për çka e paditura KEK është e obliguar që ta kompensoi mbi bazën e përgjegjësisë prej 30 %, e lidhur dispozitat e nenit 154.1, 185, 200,206 dhe 277 të LMD-së, (Ligji mbi marrëdhëniet e detyrimeve, i datës 30 mars 1978).

Gjykata vlerëson se shpërblimi i dëmit jo material nuk është shpërblim i plotë por është satisfaksion për të dëmtuarin çka në rastin konkret shumat e gjykuara janë të drejta për ta.

Për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë që ndërlidhet me dëmin jo material, gjegjësisht për dhimbjet shpirtërore të përjetuara nga paditësit, gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që vlerësoi se kompensimi përtej shumës së gjykuar, nuk do të ishte në harmoni me të mirën e shkelur, dhe me qëllim që kompensimi të ishte i drejtë dhe me rastin e vendosjes për lartësinë e kërkesëpadisë është bazuar në praktikën gjyqësore, ndërsa për pjesën e refuzuar të paditësve lidhur me dëmin material si në pikën II të kërkesëpadisë që ka të bëjë me rregullimin e lapidarit për të ndjerin, duke qenë se ky lloj i dëmit material duhet që patjetër të provohet me prova materiale në mënyrë që më pas të mundë të kërkohet kompensimi i tij ka vendosur në pajtim me nenin 253.1 pika (c) të LPK-së, sipas së cilës dispozitë parashihet se pala që parashtron padinë, duhet të përfshijë në të provat në të cilat i mbështet faktet dhe pretendimet e veta, ndërsa në nenin 428.1 të po këtij ligji ku parashihet se secila nga palët ndërgjyqëse duhet t’i parashtroj në shpjegimet e veta të gjitha faktet e nevojshme si dhe të ofrojë provat relevante lidhur me to, e që në rastin konkret paditësit nuk i kanë ofruar gjykatës ndonjë provë materiale që do të provonin faktin se të ndjerit i është ngritur lapidari apo pllaka përkujtimore e as ndonjë faturë që do që do vërtetonin këtë lloj shpenzimi.

Për kumatën gjykata ka vendosur duke u mbështetur në dispozitën e nenit 277 par të LMD-së (i datës 30 mars 1978).

Vendimin që pala e paditur t’i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452 të LPK-së dhe ka vendosë si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit. Lartësia e shpenzimeve të procedurës i referohen shpenzimeve për përpilimin e padisë në shumën prej 78.00 €, për taksën gjyqësore për padi shumën prej 375.00 €, për shpenzimet e ekspertës së psikiatrisë shumën prej 150 €, për ekspertizë elektro energjetike shumën prej 150.00€, për prezencën e avokatit në seancat gjyqësore (7x121.68€) sipas lëndës C.nr.291/2009 shumën prej 851.76€, ndërsa sipas lëndës C.nr.372/2019, për pesë(5) seanca gjyqësore, shumën prej 1,350.00€, për shpenzimet e ekspertit për mbrojtje dhe siguri në punë

shumën prej 150.00€, për ekspertizën nga lëmit e sigurimeve, akuaristikes dhe financave shumë prej 150€, ndërsa sipas lendes C.nr... të kthyer në rigjykim, për dy seanca të mbajtura shumë prej 540€, për precizimin e kërkesëpadisë shumë prej 160.00€, si dhe për super-ekspertizë shumë prej 750.00€, apo shumë e përgjithshme prej 4,704.76 €, duke u bazuar në Tarifën e Odës së Avokatëve (TAOK-së).

Nga të lartcekurat gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke u bazuar në nenin 143.1 të LPK-së.

**GJYKATATHEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË GLLOGOC,
Departamenti i përgjithshëm-Divizioni civil,
C.nr.259/23, datë 15.04.2024**

**Gjyqtari
Jeton Krasniqi**

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj Gjykate.